

ABU SEMAN  
NR 19/2018-11 PZ  
DT 30/10/2018



REPUBLIKA E SHqipërisë  
**KESHILLI KOMBËTAR I UJIT**  
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

**VENDIM**

**Nr 19 Datë 25/10/2018**

**Per miratimin e lejes se përdorimit të burimit ujore te perroit Sotires dege e lumit Tomorrice, për prodhim hidroenergjie te subjektit "HIDRO ENERGY SOTIRA" sh.p.k në Bashkine Gramsh qarku Elbasan.**

Në mbështetje të ligjit 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore" i ndryshuar me ligjin nr 6/2018 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore" neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d, neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 Keshillit te Ministrave "Per miratimin e kushteve te pergjitheshme e te posacme, dokumentave shoqeruese, afatit te vlefshmerise, formularve te aplikimit per autorizim dhe leje, procedurave te shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve te autorizimit e lejes per perdorim te burimeve ujore". Vendimit te Keshillit Kombetar te Ujit Nr 5 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Basenit Ujor" si dhe Vendimi te Keshillit Kombetar te Ujit Nr 6 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per funksionimin e Agjencise se Basenit Ujor"

Keshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

**VENDOSI:**

**Miratimin e lejes se përdorimit të burimit ujore te perroit Sotires dege e lumit Tomorrice, për prodhim hidroenergjie te subjektit "HIDRO ENERGY SOTIRA" sh.p.k në Bashkine Gramsh qarku Elbasan.**

**HEC SOTIRA**

**Vepra e marrjes Nr1**

X=429876,594 Y=4513845,268 Z=388 m

- Prurja mesatare 0,428 m<sup>3</sup>/sek.
- Prurja llogaritese: 0,695 m<sup>3</sup>/sek.
- Prurja ekologjike: 0,0642 m<sup>3</sup>/sek.

**Godina e centralit**

X=455457,1 Y=4492637,8 Z=267,3 m

Fuqia e instaluar e Hidrocentralit do te jete rreth 2340 kW

Per perdorimin e ketij burimi uxor duhet te plotesohen kushtet e meposhme:

- Te mos cenoj furnizimin me uje te popullates dhe te industrise per nevojat e tanishme dhe te prespektives.
- Te zbatoj grafikun per vaditje ne kohe (dite) dhe ne sasi (l/s) per cdo vite te hartuara nga Bordet e Kullimit te pushtetit vendore dhe ate Qendrore.
- Te respektoj grafikun e vaditjes edhe jashte periudhes kur e kerkon Bordi i Kullimit .
- Te respektoj rrjedhjen ekologjike.
- Si dhe duke plotesuar kushtet e percaktuara nga institucione qendrore dhe lokale.

Ngarkohet ABU Seman për zbatimin e këtij vendimi.

**PËRGJEGJËSI ABU SEMAN**



**PREZIDENTI I KESHILLIT KOMBËTAR I UJIT**

**Baki BALA**